RAPORT VJETOR I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PËR VITIN 2014

Përmbajtja

Hyrje.....10
Kush jemi ne.....10
Synimet dhe objektivat tona.....10
Akterët relevantë.....11
Konteksti jonë.....12
Si planifikojmë ne.....13
Plani i Punës për vitin 2014.....18
Raport Vjetor për Vitin 2014..... 19
Aktivitetet e realizuara..... 20
Standardet e Profesionit..... 20
Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve..... 22
Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP..... 37
Vizita në terren..... 43
Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim dhe Akreditim..... 45
Promovimi I KKK dhe AKK..... 48
Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat..... 50
Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara..... 68
Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes..... 69
Bashkëpunimi ndërkombëtar..... 70



Ragip GJOSHI
Kryetar i KD të AKK

Përpjekje dhe përkushtim një sistem të kualifikimeve fleksibil dhe transparent

Përkundër sfidave,me një angazhim të përbashkët të Këshillit drejtues dhe stafit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, mund të thuhet se ishte ky njëri ndër institucionet e gjithë sistemit të arsimit në Republikën e Kosovës që ndjeshëm shquhet e veçohet si agjenci me kompetencë për realizimin e misionit dhe objektivave që burojnë nga fizionomia e AKK të përkufizuar me ligj.
Këshilli Drejtues, si një Bordi qeverisës ka mbikëqyrë dhe vlerësuar performancen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Duke u angazhuar që Korniza të popullohet vazhdimisht dhe të përdorët nga planifikuesit e zhvillimit të burimeve njerëzore, fuqisë punëtore dhe individëve të cilët dëshirojnë të përmisojnë njohuritë, aftësitë, dhe kompetencat për interesin personal apo përmisimin e mundësive të punësimit.

Puna jonë ishte e orientuar në veprimin sistematik drejt zhvillimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, për të rregulluar sistemin kombëtar të kualifikimeve dhe për të harmonizuar atë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), duke mundësuar ndërlidhjen dhe komunikimin në mes të kornizave të ndryshme kombëtare. Ne, në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) jemi përkujdesuar që Sistemi Kombëtar i Kualifikimeve, të jetë i bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

Gjatë këtij viti kalendarik me angazhimin e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) dhe të Këshillit drejtues të AKK kishim për objektiv që të përmirësojë njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit formal dhe joformal dhe së fundi atij informal, ku besoj të jenë shënuar hapa të rëndësishëm.

Po ashtu, ishte ky një vit i përmbushjes së synimeve për të siguruar kualifikime që përmbushin nevojat e tregut të punës, ekonomisë dhe vizionit të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Përpjekje e vazhdueshme e këtij institucioni të përkushtuar ishte edhe angazhimi që të rregullojë kualifikimet, vlerësimin dhe certifikimin, në bazë të cilësisë dhe standardeve; të përmirësojë qasjen në vlerësim dhe njohjen e mësimit paraprak;të bëjë sistemin e kualifikimeve fleksibil dhe transparent dhe qe të krijojë mundësitë për përmirësim dhe transferimin për të gjithë.

Është në interes të theksohet se puna e zhvilluar gjatë këtij viti lidhur me realizimin e një segmenti krucial të mësimit *gjatë gjithë jetës* përfshinë të gjitha aktivitetet e mësimit, që realizohen gjatë tërë jetës për zhvillimin e njohurive, kompetencave dhe kualifikimeve duke krijuar regulativa evropiane të *njohjës së mësimit paraprak*, pra për vlerësimin e njohurive, shkathtësive ose kompetencave më të gjëra, të cilat një individ i ka arritur më herët, nëpërmjet mësimit formal, joformal ose informal.

Kjo njohuri praktike do të shfrytëzohej për ti dhënë mundësi individit që të avancohet ose të lirohet për një pjesë të kursit ose kredisë drejt kualifikimit.

Gjatë viti 2014 Këshilli Drejtues i AAK, përveq realizimit të synimit për popullimin e Kornizës ishte i përkushtuar edhe në procesin e validimit; akreditimin e ofrueseve publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional në të gjithë vendin; në dhënien e kontributit në sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale ; në strategjinë ndërvepruese e komunikmit; në konsultimin e KKK-së me akterët relevantë të KKK-së; në promovimin e KKK me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së; pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së.

Krejt në fund në emër të KD të AKK-së, për të gjithë ju pjesëmarrësit në sistemin e AAP dhe ARR , uroj një vit edhe më të sukseshëm dhe suksese të reja!



Teuta Danuza
Drejtore e AKK

Mobiliteti i nxënësve dhe fuqisë punëtore!

Gjatë vitit 2014, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka vazhduar drejt realizimit të misionit të saj: për të ndihmuar gjithë ofruesit e trajnimit dhe nxënësit, për të lëvizur drejt niveleve të përsosmërisë në arsim dhe trajnim, për të rritur cilësinë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional, për t'iu mundësuar nxënësve që të pajisen me shkathtësitë e duhura për tregun e punës dhe më e rëndësishmja, për të bërë të mësuarit gjatë gjithë jetës një mjet për të mbështetur punësimin e tyre.

Për një funksionim sa më të suksesshëm drejt përmbushjes së objektivave të KKK-së, këtë vit janë zhvilluar dhe kanë hyrë në fuqi tri Udhëzime Administrative të reja dhe një Udhëzim Administrativ është amandamentuar, në mënyrë që të lehtësojë implementimin e sigurimit të cilësisë, verifikimin e standardeve të profesionit, aprovimin e kualifikimeve, akreditimin e ofrueseve të AAP-së, si dhe validimin e të mësuarit informal dhe jo-formal.

Edhe gjatë vitit 2014, AKK-ja ka vazhduar me miratimin e kualifikimeve në nivelet 2,3 dhe 4 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe akreditimin e institucioneve që vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime. Po ashtu, ka filluar edhe me procesin e validimit të kualifikimeve në nivelin e 5-të të KKK-së dhe akreditimin e ofrueseve për këtë nivel. Ndërsa, ka për synim të mbështesë zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, duke rritur cilësinë në AAP, duke iu mundësuar nxënësve që të pajisen me shkathtësitë e duhura për tregun e punës, në një periudhe më të shkurtë kohore.

Theks i veçantë i është dhënë validimit të të mësuarit informal dhe joformal, për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për t'u dhënë vlerë të gjitha formave të të mësuarit, në mënyrë që të lehtësojë mobilitetin e kandidatëve dhe fuqisë punëtore.

AKK-ja gjatë vitit 2014, për të zbatuar një ndër funksionet kyçe të saj lidhur me KKK-në, pra përcaktimin e llojeve dhe niveleve të kualifikimeve në KKK, ka zhvilluar procesin e rishikimit dhe përpunimit të llojeve ekzistuese të kualifikimeve në KKK të Kosovës, në mënyrë që të sigurojë transparencë dhe krahasim të kualifikimeve, si dhe të lehtësojë lidhjen e tyre me tregun e punës duke inkurajuar kështu të gjithë ofruesit e AAP-së të jenë pjesë e KKK-së.

Arritja më madhore në 2014, ka qenë hartimi i raportit të lidhjes zyrtare të KKK ndaj KEK, si rezultat i një procesi mjaft të gjatë, dy vjeçar të punës dhe angazhimit serioz të AKK-së, së bashku me të gjitha palët e interesit të KKK-së. Ky raport ka për qëllim të shërbejë si mjet përkthimi dhe krahasimi i kualifikimeve që ofrohen dhe lëshohen në Republikën e Kosovës me kualifikimet e vendeve të BE-së, e që do të mundësojë mobilitet të fuqisë punëtore, pra që t'iu mundësojë qytetarëve tanë punësim edhe në vendet e BE-së.

Raporti është dërguar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja në Komisionin Evropian për ta përcjellë tek shtetet anëtare të BE-së, më konkretisht Grupit Këshillues të KEK-ut.

AKK-ja, po ashtu ka filluar bisedimet në KE që të mundësoj që AKK-ja të jetë anëtare e Grupit Këshillues të KEK, që nga shkurti i vitit 2015.

AKK-ja ka qenë mjaft aktive në ngjarjet tjera rajonale dhe evropiane në fushën e kualifikimeve dhe të sigurimit të cilësisë. AKK-ja edhe gjatë vitit 2014, ka marr pjese në të gjithat takimet e Rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP – EQAVET, si anëtare vëzhguese, si dhe në të gjitha takimet tjera rajonale të ERISEE.

AKK-ja gjatë këtij viti është ftuar nga rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP (EQAVET), si anëtare e dy grupeve punuese në nivel Evropian për zhvillimin e doracakëve në fushën e sigurimit të cilësisë dhe arsimit të të rriturve, dhe po ashtu sigurimit të cilësisë dhe sistemit të kredive për vendet e BE-së.

Për këto arritje, ne i jemi shumë mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Fondacionit Evropian për Trajnim dhe Këshillit Britanik për angazhimin dhe zotimin e vazhdueshëm për të përkrahë AKK-në drejt përmbushjes së misionit të saj që; të rrisë cilësinë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në filozofinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Unë do të doja të zgjeroj këtë falënderim për të gjithë partnerët dhe donatorët e tjerë që mbështesin punën e AKK-së!

Një falënderim i veçantë vlen edhe për ish-ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, për mbështetjen e iniciativave tona dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së dhe KKK-së. Gjithashtu, do të falënderoja Këshillin Drejtues dhe stafin ekzekutiv të AKK-së për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën gjatë vitit 2013-14!


NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve	
Këshilli Drejtues:	
Ragip Gjoshi	Kryetar i Këshillit Drejtues te AKK-se (MASHT)
Anton Gojani	Nënkryetar i Këshillit Drejtues te AKK-se (Don Bosko)
Agim Shahini	Anëtar -Aleanca Kosovare e Biznesit
Fetie Huruglica	Anëtare- Ministria e Shëndetësisë
Florent Bakija	Anëtar -Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Bedri Xhafa	Anëtar - Agjensioni i Përkrahjes së punësimit në Kosovë
Besim Mustafa	Anëtar- Oda Ekonomike
Edita Krasniqi	Anëtare -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ferdije Zhushi	Anëtare - Agjencia e Akreditimit të Kosovës
Visar Jasiqi	Anëtar- Universiteti Amerikan i Kosovës
Mehreme Llumnica	Anëtare -Handikos
Menderes Ibra	Anëtar -Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Stafi Ekzekutiv:	
Teuta Danuza	Drejtore
Avni Gashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Donjeta Nimani	Asistente Administrative

Hyrje

Kush Jemi Ne

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik i themeluar në Dhjetor të vitit 2009 bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060).

AKK ka përgjegjësi të përgjithshme për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në KKK, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional(AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të mësuarit, dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP.

AKK ka Këshillin drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe përfaqësuar nga ministritë, organizatat e partnerëve social dhe universitetet publike.

AKK ka stafin ekzekutiv prej gjashtë (6) anëtarëve: u.d drejtores, zyrtares për standarde, zyrtarit për kualifikimeve, dy zyrtarëve për sigurim të cilësisë dhe asistentes administrative.

Synimet dhe objektivat tona

Misioni i AKK-së është të mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit në gjitha nivelet, dhe në perputhmeri me nevojat dhe kërkesa e shoqërisë dhe ekonomisë.

Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.



Për të arritur këtë AKK do të:
- aprovojë kualifikime që do të përfshihen në nivelet e caktuara të Kornizës dhe riaprovojë ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit Profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çojnë tek dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna;
- bëjë rishikime periodike të vlerësimit dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- Certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në Kornizë miratohen me vulë të Autoritetit, dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AK-së

Akterët relevantë

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë, AKK krijon dhe mirëmban raporte bashkëpunuese dhe procese konsultative me të gjithë akterët relevant të KKK, përfshirë:

- Nxënësin/kandidatin
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxherët ne shkolla, Kolegje universitare dhe Universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë tek ofruesit
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Ofruesit publik dhe privat të aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë në nivel qendror dhe lokal
- Agjenci dhe Këshille në nivel kombëtare

Konteksti jonë

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) dhe Arsimit të lartë në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë adekuate nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të lartë është prioritet i Qeverisë së Kosovës, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP dhe AL të jenë në nivel të kënaqshëm. Për momentin, ende mbetet sfidë për Kosovën krijimi i një fuqie punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për t'u aprovuar dhe vendosur ne KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë ky është ndikimi i drejtpërdrejt i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë kosovare. Kjo kornizë me kriteret e saj parasheh që fillimisht institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi është i kërkuar në tregun e punës. Dëshmi mund të jenë hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT, KAAP, OEK, MPMS, etj. Gjithashtu, sipas KKK kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, që është baza e kualifikimit. Këto standarde profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr pjesë aktive nëkëtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat duhet punëtori të demonstrojë për kualifikim në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohen nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime.

AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët do t'i ndihmojnë që institucionet e arsimit dhe aftësimit profesionale të përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.



Si planifikojmë ne

AKK zhvillon politikat dhe strategjitë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060). Bazuar në objektivat strategjik të AKK-së, në zhvillojmë Planin e Punës së AKK-së duke përcaktuar prioritet dhe aktivitet për 12 muajt e ardhshëm. Stafi ekzekutiv i AKK-së është përgjegjës për zbatimin e zotimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Punës, ndërsa në çdo takim të KD të AKK-së rishikohet progresi i aktiviteteve sipas Planit të Punës.

AKK-ja paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta tek MASHT, Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë relevante të AKK çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e parashtron te Qeveria e Kosovës.

Gjatë vitit 2014 janë mbajtur 9 takime të Këshillit Drejtues të AKK. Takimet u ndoqën nga anëtarët, përfshirë edhe kryetarin e Këshillit Drejtues z. Gjoshi si dhe drejtoreshën e AKK, znj. Danuza.



KËSHILLI DREJTUES I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE





KËSHILLI DREJTUES I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE



Plani i Punës për vitin 2014

KD i AKK-së në fillim të vitit miratoi Planine Punës për vitin 2014. Synimet kryesore të AKK-së për vitin 2014, janë si më poshtë:

1. Popullimin e KKK-së me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit;

2. Akreditimin e ofrueseve publike dhe private të arsimit dhe aftësimit profesional në të gjithë vendin;

3. Dhënia e kontributit në sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale të MASHT-it

4. Strategjia ndërvepruese e komunikimit që siguron efikasitet më të madh në procesin e validimit, akreditimit dhe sigurimit të cilësisë

5. Konsultim të gjerë me akterët relevantë të KKK-së

6. Promovimi i KKK-së me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së

7. Pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së.

Plani i Punës për vitin 2014 i detajizuar mund të shkarkohet nga ueb faqja e AKK-së



Raport Vjetor për Vitin 2014

Ky raport është një përmbledhje e gjitha aktivitetet dhe objektivave të realizuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2014, në përputhje me Planin e veprimit për këtë vit, në përputhje dhe në harmoni me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, si dhe sipas Planit Vjetor të aktiviteteve, të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së. Në këtë raport do të paraqiten të ndarë në sektorë, të gjitha aktivitetet e realizuara për zhvillimin dhe implementimin e KKK, gjatë këtij viti.

Aktivitetet e realizuara

Standardet e profesionit

AKK gjatë këtij viti ka verifikuar 9 standarde të profesionit së bashku me panelet vlerësuese.
Standardet e profilit të ekonomise janë zhvilluar me mbështetje të Odës ekonomike të Kosovës dhe standardet e sektorit të sigurisë publike nga Akademia Policore për Siguri Publike. Standardet, të cilat janë përcjellë nga KAAP për verifikim dhe validim në AKK :

Nga sektori i sigurisë publike
- Nga sektori i sigurisë publike
- Zyrtar policor i ri
- Zyrtari sprovues
- Hetues dhe inspektor i inspektoratit policor të Kosovës
- Zyrtar korrektues;
- Oficer doganor
- Zjarrfikës

Nga sektori i ekonomisë
- Menaxheri i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (Themelues i Biznesit);

Nga sektori i bujqësisë
- Kuzhinier profesionist





PAMJE NGA PUNËTORITË E AAP-SË

Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve

KKK është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme. Tashmë janë rregulluar të gjithë mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave:



- Validimin dhe aprovimin e kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimin e institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimin e cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimin e kualifikimeve të validuara,
- Sistemin e Kredive;
- Njohjen e mësimit paraprak.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK-së ka mbajtur mbi 40 takime në zyrat e veta që kryesisht kishin të bëjnë me:

- Rishikimin dhe adoptimin e planit të punës,
- Përgatitjen për procesin e Validimit dhe Akreditimit,
- Përgatitjen e certifikatave dhe vendimeve për akreditim,
- Hartimin e konkurseve për panelë të ekspertëve të jashtëm dhe botimin e tyre në gazetat ditore,
- Përgatitjen e listës së ngushtë, intervistimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm,
- Përgatitjen e planeve për aktivitetet e SC të mbështetura nga Këshilli Britanik,
- Organizimin e konferencave për shtyp,
- Përgatitjen e termave të referencës për ekspertin e jashtëm të financuar nga ETF për sigurimin e cilësisë,
- Planifikimin dhe organizimin e punëtorive për sigurim të cilësisë,
- Mbështetjen për takimet e Këshillit Drejtues të AAK,
- Takime të rregullta me zyrtarët e MASHT,
- Organizimin e vizitave në teren dhe për panelet e ekspertëve të jashtëm për validim dhe akreditimin ,
- Etj



PAMJE NGA PUNËTORITË E AAP-SË

Në kuadër të rregullimit dhe zbatimit të KKK-së dhe Kornziës Kombëtare për Sigurim të Cilësisë në AAP, AKK ka hartuar draft- udhëzimin adminstrativ për sigurimin e cilësisë në Institucionet e AAP-së dhe proceset e brendshme bazuar në të gjitha kontributet e dhëna nga koordinatorët e sigurimit të cilësë të institucioneve të APP-së në një sërë seminaresh të organizuara nga AKK gjatë vitit 2013 dhe 2014.

Ky Udhëzim Adminstrativ pastaj është nenshkruar në Shtator të vitit 2014 dhe ka për qëllim që të përcaktojë parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe proceset e brendshme për sigurimin e cilësisë në institucionet e AAP-së, në përputhje me KKK dhe KKSC.

Poashtu është nënshkruar nga ministri i MASHT-it Udhëzimi Administrativ për verifikimin e standardeve të profesionit.

Ky Udhëzim Administrativ është përgatitur gjatë vitit të kaluar nga AKK-ja dhe rregullon procesin e verifikimit të standardeve në nivel shteti përmes kritereve dhe procedurave specifike.

Gjatë këtij viti është nënshkruar nga ministri i MASHT-it edhe Udhëzimi Adminstrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak - NJMP. Ky Udhëzim përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe proceduratqë do të zbatohen në implementimin e marrëveshjeve për NjMP duke përfshirë mësimin formal, joformal dhe informal në kuadër të fushëveprimit të KKK-së. Ky Udhëzim Adminstrativ madaton AKK-në që të nxjerr një udhëzues për procedurat e vlerësimit të NJM-ve në instucionet e AAP.

Për të përmbushur këtë obligim ligjor, AKK-ja me mbështetjen Këshillit Britanik përmes një eksperti ndërkombëtar, organizoi punëtorinë për zhvillimin e sistemit të vlerësimit të NJMP, si dhe Kornizës dhe infrastrukturës ligjore për akreditimin e ofruesve të AAP-së.

Pjesëmarrësit e kësaj punëtorie ishin përfaqësues nga institucionet e akredituara të Arsimit dhe Aftësimit Profesional,si dhe ofruesit tjerë të AAP-së.



Si rezulat nga kjo punëtori është draft dokumenti për "Politikat dhe procedurat e AKK-së për Njohjen e Mësimit Paraprak", e cila merr parasysh zhvillimet ndërkombëtare në NMP dhe udhëzimet Evropiane për vlerësimin e të mësuarit jo-formal dhe informal, por gjithnjë duke u bazuar në kontekstin socio-ekonomik ne vend .

Ky dokument përcakton përgjegjësitë e atyre personave të përfshirë në NMP, duke përfshirë Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, ofruesit dhe kandidatët, si dhe aktetë të tjerë të përfshirë në proces.

Ai jep udhëzime, të cilat duhet të ndiqen dhe të përmbushen në mënyrë që të ndërtohet dhe mirëmbahet një sistem i fuqishëm ivlerësimit të mësimit paraprak.

Kjo synon t'i ndihmojë ofruesit dhe organizatat tjera të përfshira në procesin e njohjes së mësimit paraprak, përmes dhënies së kualifikimeve të akredituara nga AKK-ja, për të zhvilluar apo azhurnuar politikat dhe udhëzimet e tyre për NMP-të, me qëllim të përmbushjes së kërkesave të AKK-së.



Pamje nga konferenca e mbajtur në Prishtinë për procesin e referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve – KKK në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve-EQF



Gjatë vitit 2014 Autoriteti Kombëtar me mbështetje të Këshillit Britanik në Kosovë, ka zhvilluar procesin e referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve – KKK në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve-EQF duke hartuar kështu raportin e Referencimit të KKK ndaj EQF. Objektivi kryesor i këtij raporti është qëtë bëhet ndërlidhja dhe krahasueshmëria e sistemit dhe kualifikimeve ndërmjet KKK dhe KEK bazuar në në 10 kriteret e referencimit:

1. Përgjegjësitë dhe kompetancat ligjore tëtë gjitha organeve kombëtare të përfshira në procesin e referencimit,
2. Lidhja e niveleve të kualifikimeve të KKK me KEK,
3. KK dhe validimi i të mësuarit formal e jo formal, sistemi i kredive,
4. Procedurat për përfshirjen e kualifikimeve në KK,
5. Sistemi i sigurimit të cilësisë,
6. Përfshirja e akterëve/ofruesëve në sigurimin e cilësisë,
7. Përfshirja e ekspertëve ndërkombëtar në procesin e referencimit,
8. Organi/organet kompetente për referimin e KKK me KEK,
9. Platforma zyrtare e KEK,
10. Afatet kohore të përcaktuara në rekomandim.



Pamje nga konferenca e mbajtur në Prishtinë për procesin e referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve – KKK në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve-EQF



Gjatë vitit 2014 Autoriteti Kombëtar me mbështetje të Këshillit Britanik në Kosovë, ka zhvilluar procesin e referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve – KKK në
Pasi që raporti i referencimit të KKK me KEK ndërtohet në tri shtylla kryesore në sistemin e arsimit të përgjithshëm, në arsimin dhe aftësimin profesional, si dhe arsimin e lartë në Kosovë, që nga Janari i vitit 2014 AKK-ja organizoi 6 punëtori në fushat përkatëse të arsimit të Kosovë, duke marr në konsideratë edhe inputet, vërejtjet dhe plotësimet e palëve me interes që kanë qenë pjesëmarrëse në punëtoritë e organizuara për këtë qëllim.

Me qëllim të diskutimit rreth këtij dokumenti, plotësimit dhe finalizimit, AKK-ja themeloi edhe një grup bërthamë të punës, për hartimin e raportit. Kjo detyrë është kryer në forma të ndryshme; përmes 7 takimeve/punëtorive të grupit të ngushtë dhe punëtorive me akterët kyç të AAP-së të organizuara në Durrës, Tiranë dhe Prishtinë.



Pamje nga konferenca e mbajtur në Prishtinë për procesin e referencimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve – KKK në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve-EQF



AKK-ja gjatë hartimit të draftit-raportit, në vazhdimësi është konsultuar edhe me ekspertë ndërkombëtar rreth rekomandimeve, të cilat janë inkorporuar në këtë raport dhe që kanë pasur ndikim në cilësinë e raportit.

Ndërsa, në fund të këtyre takimeve u organizua një diskutim publik, i cili u përmbyll me prezantimin e raportit final në konferenca rreth Raportit të Referencimit së Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

AKK-ja me këtë konferencë përfundoi raportin e referncimit të KKK me KEK dhe ai tani është dërguar nga ministri i Arsmit, Shkencës dhe Tekonologjisë, Ramë Buja në Komisionin Evropian për ta përcjellë tek shtetet anëtare të BE-së, më konkretisht Grupi Këshillues të KEK për vlerësim.

AKK-ja gjatë vitit 2014, për të zbatuar një ndër funksionet kyçe të saj lidhur me KKK-në, pra përcaktimin e llojeve dhe niveleve të kualifikimeve në KKK, ka zhvilluar procesin e rishikimit dhe përpunimit të llojeve ekzistuese të kualifikimeve në KKK të Kosovës, në mënyrë që të sigurojë transparencë dhe krahasim të kualifikimeve dhe të lehtësojë lidhjen e tyre me tregun e punës.

Objektivat e këtij procesi ishin: për të mbështetur menaxhimin e KKK-së në Kosovë duke bërë dallimet në mënyrë më të qartë në mes të kualifikimeve, të cilat janë në përgjegjësi të AKK-së, AKA-së dhe MASHT-it; për të mbështetur komunikimin në mes të këtyre organeve në lidhje me Kornizën dhe përmbajtjen e saj; për të bërë natyrën e kualifikimeve në kornizë më të lehtë për t'u kuptuar nga përdoruesit; për të ofruar më shumë mundësi për njohjen formale të të nxënit e llojeve të ndryshme, si dhe për të mbështetur forma të ndryshme të të nxënit gjatë gjithë jetës në Kosovë, dhe për të mbështetur dhe inkurajuar zhvillimin e fuqisë punëtore në Kosovë.

Ky proces është mbështetur nga ekspertë të jashtëm nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve dhe janë organizuar 6 takime dhe 6 seminare me palët e interesit nga Arsimi i Lartë dhe Arsimi i Përgjithshëm dhe AAP. Seminaret u fokusuan në definimin e llojeve dhe tipeve të kualifikimeve në KKK për të marr në konsideratë të gjitha palët e interesit.



Në këto seminare janë distuar dhe hartuar kriteret e klasifikimi të kualifikimeve dhe propozimet për sistemin e kualifikimeve në Kosovë, duke definuar llojet dhe tipet kualifikimeve në KKK. Këto lloje dhe tipe të kualifikimeve janë hartuar mbi gjendjen aktuale të sistemit të Kosovës, të cilat gjithashtu kanë vizion për në të ardhmen dhe janë bazuar në parimet, si një vijim:

- Kufizimet strukturore (*p.sh., rregullat e Kornizës së Bolonjës, Korniza e Kurrikulës së Kosovës, ose përdorimi i standardeve kombëtare profesionale)*

- Qëllimin (*p.sh., zhvillimi akademik, personal, përvetësimi i shkathtësive dhe njohurive të reja, arritja e kompetencës profesionale)*

- Përmbajtjen (*p.sh., përmbajtja e bazuar në disiplinat akademike, lëndët mësimore, një profil profesional, një grup shkathtësish të ndërlidhura me një rol të punës)*

- Llojet e rezultateve që duhet të arrihen dhe të vlerësohen (*p.sh., njohuritë ose shkathtësitë gjenerike, njohuri ose shkathtësi specifike për lëndë ose profil, shkathtësi për të menaxhuar situatat e punës, ose njerëzit)*

- Nivelin e vështirësisë (*ku kualifikimi përshtatet në KKK, bazuar në krahasimin në mes të r ezultateve të kualifikimit dhe përshkruesve të nivelit të KKK-së)*

- Madhësinë (*shprehur në vlerën e kredisë së bazuar në orë imagjinare të të nxënit të cilat përfshijnë kohën e nevojshme për klasë, mësimin individual dhe vlerësimin (në arsimin e lartë në Kosovë 1 ECTS kredi është dhënë për 20 orë imagjinare të të nxënit dhe në arsimin dhe aftësimin profesional, 1 kredi ECVET është dhënë për 10 orë imagjinare të të nxënit)*

- Rekomandimet dhe/ose kërkesat e hyrjes (*kualifikimet e mëparshme dhe/ose përvojë e cila rekomandohet ose kërkohet si një bazë për marrjen e kualifikimit)*

- Rregullimet për sigurimin e cilësisë (*agjencitë përgjegjëse për validimin, akreditimin, vlerësimin, proceset dhe kriteret e përdorura për sigurimin e cilësisë)*

Gjatë vitit 2014 AKK-ja ka organizuar 4 runde të procesit të validimit kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve ofruese dhe vlerësuese për kualifikime të zhvilluara sipas standardeve të verifikuara kombëtare, apo ndërkombëtare. Këto 4 procese u mbajtën gjatë këtyre muajve: Prill, Qershor, Korrik dhe Tetor. Gjithsej ishin 6 panele.



Po këtë vit, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bëri shpalljen e procesit të akreditimit për kurset e gjuhës angleze, si dhe për herë të parë në këtë proces morën pjesë edhe kursete gjuhës gjermane. Në proces të akreditimit për gjuhë gjermane ishte një panel dhe u mbajtën 2 vizita, ndërsa sa i përket gjuhës angleze në proces të akreditimit dhe riakreditimit ishin 2 panele dhe 5 vizita. Gjatë këtij viti, është bërë edhe rishikimi i kushteve për kurset e gjuhës angleze, kushte këto të dala nga procesi i kaluar, për çka janë bërë 4 vizita nga 2 panele.


Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP-së

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, ka planifikuar, organizuar dhe ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me Validimin dhe Akreditimin e ofruesve të AAP, përfshirë edhe vizitat e paneleve të ekspertëve në teren. Për këtë proces janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse.

Në fillim të procesit për secilin raund është mbajtur një takim me të gjithë ekspertët e paneleve. Këto takime kishin karakter informues në lidhje me procesin e validimit dhe akreditimit të Institucioneve aplikuese.

Procedurat dhe vijueshmëria e punës lidhur me gjitha grupet e panelit ishte si ne vijim:
-Takimi për shqyrtimin e aplikacioneve;
-Vizita në terren;
-Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim të kualifikimit dhe Akreditim të ofruesve
-Takim për shqyrtimin e aplikacioneve

Pas takimit të parë informues rreth procedurave të validimit dhe akreditimit, zakonisht janë mbajtur edhe takimet e paneleve për shqyrtimin e materialeve dhe dokumenteve të institucioneve aplikuese.



Pamje nga vizita gjatë procesit të akreditimit.



Pamje nga vizita gjatë procesit të akreditimit.



Pamje nga vizita gjatë procesit të akreditimit.


Book



Pamje nga vizitat gjate procesit të akreditimit.



Vizita në terren

Gjatë vizitave ne terren panelet u pritën nga menaxherët e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit/trajnerët e profileve përkatëse, nxënësit ose pjesëmarrësit e trajnimeve dhe janë vizituar disa punëtori dhe institucione, në të cilat këta kandidatëjanë duke e kryer pjesën praktike.

Fillimisht gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas Aplikacionit për Validim të kualifikimeve.

Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

-Modulet

-Struktura e kualifikimit

-Numri i kredive

-Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/modulit

-Niveli i kualifikimit/modulit në KKK

-Pjesa teorike dhe praktike

-Standardet profesionale

-Njohja e mësimit paraprak

-Mënyra dhe kriteret e vlerësimit

-Literatura

Po ashtu gjatë vizitës edhe sipas aplikacionit për Akreditimin e ofruesve u bë verifikim i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve duke përfshire këto pika:

-Pajisjet dhe mjetet për praktikë;

-Kabinetet dhe punëtoritë;

-Gjendja financiare;

-Stafi dhe menaxhmenti;

-Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta;

-Qasje të barabartë për kandidatë;

-Siguria dhe shëndeti;

-Certifikimi;

-Data baza

Gjatë këtij procesi u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.



Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim dhe Akreditim

Në kuadër të këtij procesi, panelet përkatëse përpiluan draft-raportet për validimin dhe akreditimin për kualifikimet përkatëse të institucioneve aplikuese. Raportet u krijuan duke u bazuar ne dokumentet, materialet dhe dëshmitë e ofruara, përfshirë edhe vizitat në institucione dhe dëshmitë shtesë, si dhe informata kthyese nga institucionet përkatëse. Raportet janë pasqyrim i gjendjes të ofruesit dhe vlerësimi i panelit u bazua konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrur nga Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha draft-raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin/ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA.

Pas kësaj procedure, raportet finale janë dërguar Këshillit Drejtues të AKK me rekomandime për aprovim, ose mos aprovim.

Duhet theksuar se i tërë ky proces gjatë vitit 2014 pa marrë parasysh vështirësitë dhe numrin e kufizuar të stafit që ka AKK-ja, ka shkuar jashtëzakonisht mirë dhe në frymën e një bashkëpunimi shumë të ngushtë me Institucionet aplikuese dhe palët me interes të përfshira në proces.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, nga procesi i lartpërmendur ka rezultuar me validimin dhe regjistrimin e këtyre kualifikimeve në KKK:

-Nëpunës i shërbimeve bankare dhe
- Zjarrfikës

Gjatë vitit 2014 u rishikuan edhe Institucionet e akredituara me kusht gjatë vitit 2013 si në vijim:

-Instituti për banka dhe financa	Nëpunës i shërbimeve bankare
-Kolegji Biznesi	Zjarrfikës
-Oxford Studio	Gjuhë angleze
-New Age	Gjuhë angleze
-Britannica ELT	Gjuhë angleze
-London Eye	Gjuhë angleze

Institucionet e akredituara për gjuhë angleze dhe gjermane ishin:

- English Language Centre	Gjuhe angleze
- APPK	Gjuhë angleze
	Gjuhë gjermane
- PTK	Gjuhë angleze
- Cambridge School Prishtinë	Gjuhë angleze
	Gjuhë gjermane
- Qatar Charity Infinite	Gjuhë angleze

Promovimi I KKK dhe AKK

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji te vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të gjitha palët e interesit, duke përfshirë publikun e gjerë, të informuar mirë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme si në vijim:

- Mbajtja e takimeve me palët e interesit (ofruesve publik, privat dhe në përgjithësi të ofruesve të AAP) në baza të rregullta
- Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat
- Organizimi i ceremonisë për shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit,
- Pjesëmarrja në konferenca lokale, regjionale dhe vizita studimore,
- Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara
- Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar.
- Zhvillimi dhe rishikimi i ëeb-faqes,
- Publikimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme, etj.



Pamje nga pjesëmarrja e AKK-së në Panaririn "Të mesuarit gjatë gjithë jetës"

Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat

Gjatë vitit 2014 u mbajtën një mori konferencash, punëtorish informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik/privat.

U realizuan shtatë (7) seminare për Sigurim të Cilësisë në rajonin e Prishtinës, Ferizajt, Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit dhe Istogut.

Tri seminaret e para me temë; Verësimi dhe monitorimi në arsim, kishin për qëllim vlerësimin në arsim në AAP, dizajnimin e procesit të vlerësimit në AAP, llojet dhe modelet e vlerësimit, vlerësimi i bazuar në performancë dhe procesi i monitorimit, si dhe dëshmitë në vlerësim.

Seminaret e fundit të mbajtura kishin për temë: "Mentorimin në AAP" ku pikat e realizuara ishin, të kuptuarit e cikleve të mentorimit, rëndësinë e përgatitjes së planit të mentorimit para dhe pas vëzhgimit, rëndësinë e përgatitjes së mënyrës së dhënies së informatës kthyesepër dhënësin dhe pranuesin, si dhe diskutimi dhe harmonizimi i qasjes mbi përgaditjet për hartimin e raportit të vetëvlerësimit, planit të përmirësimit dhe procesin e verifikimit të jashtëm (monitorimin) që lidhet direkt me mentorimin.

Në këto seminare morën pjesëpërfaqësues të shkollave të AAP-së, siç ishin drejtorët, koordinatorët për sigurim të cilësisë, udhëheqësit e aktiveve profesionale dhe mësimdhënës të tjerë. Si pjesëmarës tjerë ishin edhe përfaqësuesit nga kurset e gjuhës angleze,përfaqësues nga MASHT, DKA, Inspektoriati, Instituti Albanologjik i Kosovës. Numri total ishte 450 pjesëmarrës.

AKK-ja me qëllim që të prezantohet "Udhëzimi Administrativ NR. 32/2014 Për Kriteret dhe Procedurat Për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional-Proceset e Brendshme", shpërndarja e certifikatave për pjesëmarrësit në seminaret e organizuara nga AKK-ja për "Mentorim dhe vetëvlerësim". Në këto punëtori u bë solemnisht ndarja e certifikatave për pjësëmarrësit në seminaret

Në nëntor të vitit 2014 u mbajtëngjashtë punëtori përmbyllëse të organizuara nga e organizuara nga AKK-ja, ku u diskutua: qëllimi i Udhëzimit Administrativ, terminologjia e tij, parimet të cilat mbështesin proceset e brendshme për sigurimin e cilësisë, përgjegjësitë e IAAP-së për sigurimin e cilësisë në IAAP, përgjegjësitë e Zyrës për sigurim të cilësisë, proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, hyrja në fuqi e tij dhe obligimet.

Në këto punëtori morën pjesë nga dy përfaqësues nga shkollat, drejtorët dhe koordinatorët për sigurim të cilësisë. Gjithashtu pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga DKA, MASHT, IPK dhe inspektorët regjionalë që e mbuluan fushën e AAP-së nga regjioni i Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Pejës, Gjakovës, Prizrenit dhe Institucionet e arsimit të akredituara të kurseve të gjuhës Angleze.



PAMJE NGA PUNËTORITË E AAP-SË



AKK-ja në Tetor të 2014 organizoi punëtorinë për vlerësimin dhe standardet e niveleve të kualifikimeve. Punëtoria kishte për synim ngritjen e kapaciteteve tek ofruesit e AAP lidhur kriteret e performaces, standardet dhe metodat e vlerësimit, si dhe rezultatet e mësimit bazuar në njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat për nivelet dy, tre dhe katër të kualifikimeve.Gjithashtu, pjesëmarrësit u informuan lidhur me zhvillimet e fundit në AKK lidhur me zbatimin e KKK-se dhe rëndësinë e procesit të aprovimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve që ofrojnë kualifikime profesionale në Kosovë.
Pjesëmarrësit e kësaj punëtorie ishin përfaqësues nga institucionet e akredituara të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe njëkohësisht profesionist të këtyre fushave.

AKK-ja po ashtu këtëvit ka bërë regjistrimin e kualifikimeve të validuara në KKK – për profilet nëpunës i shërbimeve bankare dhe zjarrëfikës për nivelet 3.



TAKIM RRETH RAPORTIT TE VETË-VLERËSIMIT



Gjatë muajit dhjetor të vitit 2014, në Hotel "Grand" në Prishtinë, Autoriteti Kombëtar I Kualiikimeve mori pjesë në panairin me titull "Java e të mësuarit gjatë gjithë jetës", i cili u organizua nga MASHT, MKRS dhe MPMS në bashkëpunim me DVV International.

Qëllimi i këtij panairi ishte promovimi dhe demonstrimi i punës me të rritur nga Shkollat e mesme profesionale, Qendrat e aftësimit profesional, Qendrat rinore, ofruesit privat të trajnimeve, OJQ-ve vendore (Rreth 40 ofrues vendor të arsimit formal, jo formal dhe informal në Kosovë).

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve promovoi dhe shperndau një sasi të konsiderueshme të disa dokumenteve të prodhuara nga AKK, sic janë:

- Fletushka informative për AKK dhe KKK
- Ligji për Kualifikime Kombëtare
- Pako udhëzuesish nga AKK
- Udhezimi Administrativ për kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit,
- Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional – Proceset e brendshme
- Udhëzimi Administrativ për njohjen e mësimit paraprak
- Udhëzues për njohjen e mësimit paraprak dhe
- Kalendarë nga AKK



PAMJE NGA PUNËTORITË RRETH SIGURIMIT TË CILËSISË





PAMJE NGA PUNËTORIA E ORGANIZUAR PËR STANDARDE, REZULTATE MËSIMORE, NIVELE DHE VLERËSIM





PAMJE NGA PUNETORIA E ORGANIZUAR PËR STANDARDE, REZULTATE MËSIMORE, NIVELE DHE VLERËSIM





PAMJE NGA CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË CERTIFIKATAVE TË TRAJNIMEVE DHE PREZANTIMIT TË HULUMTIMEVE RRETH QËNDRIMEVE PËR AKK DHE KKK





PAMJE NGA CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË CERTIFIKATAVE TË TRAJNIMEVE
DHE PREZANTIMIT TË HULUMTIMEVE RRETH QËNDRIMEVE PËR AKK DHE KKK





PAMJE NGA CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË CERTIFIKATAVE TË TRAJNIMEVE

Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë shumë i angazhuar në dizajnimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të prodhuara nga ai vetë. Dokumentet kryesore janë publikuar në formë të shtypur, me dizajn dhe shenjë adekuate, në tri gjuhët:shqipe, angleze dhe serbe, dhe u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ofrojnë Trajnime, Arsim dhe Aftësim, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.



Këto publikime janë grupuar si më poshtë:

1.Fletushka informative për AKK dhe KKK
2.Raportet vjetore të 2013, në të tri gjuhët
3.Postere për Sigurim të Cilësisë
4.Udhezimi Administrativ për krieret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit,
5.Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional – Proceset e brendshme
6.Udhëzimi Administrativ për njohjen e mësimit paraprak

AKK-ja, po ashtu ka publikuar një fletushkë informative që përmban informata mbi rolin e saj në raport me KKK-në, kualifikimet e aprovuara në KKK, ofruesit e AAP-së të akredituara nga AKK-ja, si dhe përfitimet e individit, partnereve social dhe ofrueseve të AAP-së nga zbatimi i KKK-së. Fletushka është shpërndarë në një numër të madh të ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme me palët e interesit.

Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara

Për të gjeneruar vetëdijesimin e publikut në përgjithësi, është zhvilluar një fushatë me reklama televizive. Kjo ka përfshirë edhe reklamat në kanale televizive kombëtare. Mesazhi i AKK-së që është promovuar në mediat elektronike, ka pasur për qëllim që të ngrisë vetëdijen e njerëzve për përfitimet e kandidatëve nga procesi i zbatimit të KKK-së, duke krijuar mundësi të reja për t'u bërë të kualifikuar, ose të ketë kualifikime të njohura, për bizneset duke siguruar se kualifikimet janë të dizajnuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës, dhe për ofruesit duke mbështetur zhvillimin e një tregu për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Drejtoresha e AKK-së ka marr pjesë në një sërë programesh televizive dhe të radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja përzbatimin e KKK-së, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i saj. Gjatë vitit 2014 janë përcjellur aktivitet e AKK-së, të cilat u publikuan në mediat e shkruara dhe u paraqiten në TV nacionale dhe lokale. Artikuj të ndryshëm mbi aktivitet e AKK-së u publikuan në këto mediume: Koha Ditore, Zëri, InfoPress, Kosova Sot, Exspress, Lajm, Tribuna Shqiptare dhe Epoka e re.




PAMJE NGA REKLAMA TELEVIZIVE E AKK-SË

Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes

Zhvillimi dhe lancimi i ueb-faqes së AKK-së është bërë në tri gjuhë. Ueb-faqja përmban informata themelore për AKK dhe KKK, dokumente dhe publikime, të cilat janë aprovuar nga KD i AKK.

Ueb-faqja gjithashtu përmban materialet publikuara për t'iu ofruar të gjitha palëve të interesuara dokumentet në format elektronik. Gjithashtu në këtë ueb faqe është e publikuar edhe lista për institucionet e akredituara. Megjithatë, ueb-faqja është përmirësuar për të sistemuar një sasi më të madhe të informatave dhe për të ofruar mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me ueb-faqet përkatëse. Në Ueb-faqe janë vendosur edhe video dhe audio incizimet që janë të përdorë në fushatën e mediave për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

AKK-ja gjatë vitit 2014 ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga EQAVET, ERI SEE dhe ECVET.
Sukses i jashtëzakonshëm i AKK-sëështë se gjatë këtij viti është ftuar nga rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP (EQAVET), si anëtare e dy grupeve punuese ne nivel Evropian. Komisioni Evropian pas diskutimeve me përfaqësues të Shteteve anëtare në rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP (EQAVET) dhe përdoruesit e rrjetit të, ka kërkuar nga EQAVET dhe rrjetit Evropian për Sistem të Kredive në APP (ECVET) të themelojë një një grup të përbashkët punues, anëtare e së cilës është edhe AKK-ja. Këtërast, takimi I parë është mbajtur në Paris, synimi i të cilit ishte të fuqëzimi i bashkëpunimit, shkëmbimi i informatave dhe sigurimi i udhëzimeve për shtetet anëtare, si dhe këshilla në Komisionin Evropian.
Poashtu, bazuar në zhvillimet në nivel të BE-së është themeluar një grup punues nga KE që përbëhet nga anëtarët e Rrjetit EQAVET dhe Grup Tematik mbi Arsimin e të Rriturëve. Takimi i parë është mbajtur në Bruksel dhe synimi i takimit ishte nxitja e një kuptimi të përbashkët mbi parimet / kriteret dhe treguesit e cilësisë përkatëse të KAAP-së, të ndërtuar mbi punën e zhvilluar nga Rrjeti EQAVET dhe Grupi Tematik mbi AARr, si dhe mbështetja e anëtarëve të rrjetit EQAVET dhe palët tjera të interesit në adresimin e çështjeve të sigurimit të cilësisë të rëndësishme për AAP.

AKK-ja në fillim të vitit është ftuar për vizitë në Agjencinë Kombëtare të Arsimit e Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, nëTiranë. Ojektiv i kësaj vizite, ishte bashkëpunim në fushën e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në mes të AKK dhe KSHK, marr parasysh që Kosova është më e avancuar sa i përket KKK përfshirë: Harmonizimin e metodologjisë për zhvillimin e Standardeve te profesionit;Harmonizimin e metodologjisë për zhvillimin e Kualifikimeve Kombëtare; Harmonizimin e metodologjisë për sigurimin e cilësisë; Harmonizimin e procedurave dhe kritereve për validimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e ofruesve të AAP, si dhe Harmonizimin e procedurave dhe kritereve për verifikimin e standardeve te profesionit.

AKK-ja gjatë muajit Tetor ka marr pjese në një vizitë në Kolegjin e Sheffield, si pjesë e një delegacioni nga Kosova mbeshtetur nga projekti Lux Development. Objektivat e përgjithshme të kësaj vizitëstudimoreishin: informimi në lidhje merolin, fushëveprimin e punësdhe përgjegjësisësë e City College në Sheffield, me theks të veçantëmbi rolin, qëllimin epunës dhepërgjegjësitë eCity College në Sheffield;në veçanti lidhur me ofrimin e kualifikimeve të nivelit 2, 3, 4, dhe 5; ndërlidhjen e kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës përmeshulumtimit të tregut të punës, analizimitdhe përpunimit të të dhënave lidhur mezhvillimin e standardevetë profesioneve dhe kualifikimeve profesionale; sistemin e sigurimit të cilësisë përmes procesit të vlerësimit të vazhdueshëm, përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin e jashtëm të sistemit të AAP-së.

AKK-ja poashtu ka marr pjesë në një seminar njëditorë të organizuar nga Autoriteti Skotlandez i Kualifikimeve lidhur me implementimin e Njohjes së Mësimit Paraprak. Objektivat e përgjithshëme të kësaj punëtorie ishin të ofrojë udhëzime për mekanizmat e të të gjithë atyre, të cilët përfshihen në NjMP për arsim, aftësim, për qëllime të tregut të punës, si dhe sigurimin e cilësisë duke përshkruar këtu edhe mekanizmat për t'u akreditуar si Institucion Vlerësues, mekanizma dhe rregulla për qasje të kandidatëve në vlerësim dhe certifikim. Poashtu, janë përshkruar kushtet e nevojshme për NJMP, të cilat shpien në njohjen e kredive në KKK, ose në një nivel të avancuar të kualifikimit të validuar në KKK.



PAMJE NGA KONFERENCA E MBAJTUR NË BRUKSEL E ORGANIZUAR NGA ETF



AKK-ja poashtu ka marrë pjesë në një takim në Agjencisë për Arsim Profesional dhe Trajnim dhe Edukim të Rritur (CPI) në Slloveni, për tu informuar në lidhje me rolin, fushëveprimin e punës dhe përgjegjësisë e CPI-së, si dhe veçanërisht për diskutuar mundësinë e bashkëpunimit si dy agjenci shtetërore.

Synimi i delegacioneve nga të dyja palëtishte krijimi i një platforme për bashkëpunim nëmes tëdy agjencive për procedurat e vlerësimit, vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm të sistemit të arsimit të rriturve. Qëllim tjetër ishte edhe bartja e përvojave në përgatitjen e metodologjisë për zhvillimin e programeve arsimore për të rriturit, duke siguruar mendimin profesional për programe dhe bashkëpunim në përgatitjen e projekteve IPA në fushën e arsimit.

AKK-ja është ftuar dhe ka marrë pjesë në takimet rajonale të ERISEE-së me shtetet fqinje të Ballkanit Përëndimor, përfshirë punëtorinë e organizuar në Mal të Zi.

Synimi i kësaj punëtorie ishtë që të realizohet një projekt rajonal, për të identifikuar dhe zbatuar masat dhe veprimet kyçe strategjike, të cilat do të përmirësojnë qasjen në arsim, rritjen e shkallës së përfundimit të shkollimit dhe luftimin e braktisjes sëshkollave, në të gjitha nivelet e arsimit.

Masat dhe veprimet e propozuara në këtë projekt do të mbështesin vendet në rajon për të sjellë më shumë fëmijë në shkollë (sidomos fëmijët me prejardhje të margjinalizuar), për të ndihmuar të rinjtë kalimin e një tranzicioni të suksesshme nga një nivel në një nivel tjetër të arsimit, si dhe për të përmirësuar lidhjen e njohurive dhe aftësive të fituara përmes edukimit.

Fokusi i veçantë është vënë në barazi në kuadër të arsimit (pa dëmtuar cilësinë) si; qasja në arsim dhe në përfundimin e arsimit.

Pjesëmarrësit janë ndarë në grupë punuese për të diskutuar sfidat, aktivitetet dhe rezulatet lidhur me një project të mundshëm.



PAMJE NGA KONFERENCA E MBAJTUR NË BRUKSEL
E ORGANIZUAR NGA EQVET RRETH SIGURIMIT TË CILËSISË



PAMJE NGA VIZITA STUDIMORE NË SALZBURG, AUSTRI

AKK-ja gjatë vitit 2014 ka marrë pjesë në një puntori në Tiranë me ftesë të IMF-së. Objektivat e përgjithshme të kësaj punëtorie ishin, informimi në lidhje me Partneritetin Publiko-Privat (PPP) në Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira nga vendet e zhvilluara, si Australia dhe Izraeli. Pastaj, diskutimi i sfidave, si dhe nxjerrja e një sërë rekomandimesh për implementimin e PPP në Kosovë dhe Shqipëri.



AKK-jaka marrë pjesë në Konferencën dy ditore të mbajtur në Stamboll të Turqisë.

Qëllimet e vizitës ishin papunësia në tregun evropian për shkak të shkurtimit të vendeve të punës dhe digjitalizimit dhe gjetja e alternativave, ndërlidhja e ekonomisë në identifikimin e prirjeve për shkathtësitë e nevojshme për biznese dhe vet ekonominë, sa janë të përgatitur të rinjtë me shkathtësitë e duhura për tregun e punës, për t'i përmbushur nevojat e tregut të punës, sfidat dhe mundësitë e secilit vend për të përmirësuar arsimin dhe aftësimin profesional, paraqitja e alternativave, roli dhe përgjegjësia e industrisë për të siguruar shkathtësitë punuese për në të ardhmen, si dhe vlerësimi i sistemeve tëvendeve të ndryshme të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional duke u bazuar edhe në përvojat e tyre etj.

AKK-ja ka marrë pjesë në vizitën studimore të mbajtur në Irlandë, e cila u organizua në kuadër të projektit TEMPUS LO@HEI.Të arriturat e kësaj vizite ishin, të kuptuarit dhe të shkruarit e rezultateve të të nxënit, të kuptuarit e formatit të rezultateve të të nxënit, dallimi në mes rezultateve të të nxënit dhe kompetencave, të kuptuarit rreth implementimit të rezultateve të të nxënit, identifikimi i përgjegjësive rreth implementimit, përfitimi nga përvojat më të mira në praktikë, etj.

AKK-ja në Prill të vitit 2014, me ftesë nga ETF mori pjesë në konferencën me titull "Si t'i bëjmë kualifikimet më të mira", e cila u mbajt në Belgjikë.
Qëllimi i kësaj konference ishte shqyrtimi se si vendet partnere në tranzicion janë duke reformuar sistemet dhe kualifikimet e tyre, duke përfshirë përdorimin e Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve. Konkluzionet e dala nga kjo konferencë ishin: analizimi dhe identifikimi se shumica e shteteve përballen me sfida dhe probleme të ngjajshme, se të mësuarit ka pësuar ndryshime në qasje nga ajo tradicionale (këtu përfshihen kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, përfshirja e partnerëve social, etj.), rezultatet e të nxënit të tregut të punës duhet të jenë të bazuara në aftësi, të kuptuarit rreth implementimit të mjeteve dhe praktikave evropiane, siç janë instrumentet për sigurim të cilësisë, sistemi i kredive, etj.

Në Maj 2014, AKK-ja ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare dy ditore, në Podgoricë. Në këtë konferencë të pranishmit janë njoftuar me zhvillimin dhe implementimin e Kornizës së Kualifikimeve në Evropë, zhvillimin e Kornizës së Kualifikimeve të Estonisë dhe mënyra e organizimit të implementimit të kësaj kornize, raporti i referencimit të Kornizës së Kualifikimeve të Malit të Zi me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve nga ekspertët e angazhuar për këtë çështje, mundësia që ofron Korniza e Kualifikimeve si princip i përbashkët për sigurim të cilësisë në sistemin arsimor si të secilit vend ashtu edhe në nivel evropian, implementimi i rezultateve të të nxënit përmes Kornizës së Kualifikimeve dhe ECVET, roli i partnerëve social në zhvillimin dhe implementimin e Kornizës së Kualifikimeve, angazhimi dhe fuqizimi dhe i partnerëve social për pjesëmarrje në zhvillimin e kualifikimeve, analizimi i tregut të punës për të evidentuar kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, procesi i zhvillimit te kualifikimeve dhe roli i standardeve të profesionit drejt zhvillimit të tyre, etj.



Pamje nga prezentimi i përfaqësuesve të AKK-seë në konferencën e mbajtur në Podgoricë

WUS Kosova, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencioni i Akreditimit të Kosovës dhe përfaqësues nga Institucionet e bartësve të Arsimit të Lartë privat nga Kosova.Pikat, të cilat u diskutuan në këtë vizitë ishin të rejat në kontekstin e politik bërjes në EQAVET sipas raportit kombëtar të referimit, ose të rejat relevante në kontekstin e nivelit kombëtare sipas vendeve pjesëmarrëse, ku të gjitha vendet anëtare pjesëmarrës eprezantuan të arriturat, të rejat relevante dhe sfidat për sigurimin e cilësisë, por këto projekte qëllim kishin sistemet dhe nivelet e ndryshme, shumica në kontekstin nacional të iniciuara për AAP dhe vazhdimin e zhvillimit profesional, rifreskim nga projekti Erasmus +, prezantim për të rejat nga Cilësia e Arritur Në Të Mësuar dhe Trajnim me Biznese të vogla dhe Mikro biznese në Evropë nga CDFOP. Këto projekte pritej që të krijojnë qasje për sigurim të cilësisë duke e adoptuar Kornizën Evropiane për Sigurim të Cilësisë, dhe për pasojë ato filluan të marrin aksione dhe të përshkruajnë praktikat ekzistuese dhe iniciativa të qëndrueshme. Dhe qëllimi i tyre ishte gjithashtu dizajnimi, zhvillimi dhe implementimi i sigurimit të cilësisë në nivelet e përzgjedhura, përdorimi dhe vendosja e mjeteve dhe metodologjisë, dizajnim i gjerë kampanjës dhe komunikim specifik në marrëdhënie me palët me interes.

AKK-ja, në Tetor të vitit 2014 me ftesë tëProjektit TEMPUS LO@HEI,mori pjesë në vizitën studimore në Universitetin e Edinburgut. Temat e diskutuara në këtëvizitë ishin: roli i Institutit për Zhvillim Akademik, rrjeti pasuniversitar për diskutim dhe komunikim, ofrimi i arsimit pasuniversitar nga Instituti për Zhvillim Akademik, ofrimi për zhvillim të studimeve nga Instituti për Zhvillim Akademik, projekti për përvojat e studentëve, me qëllim për të ofruar një kuptim më të mirë të përvojave të studentëve, për të pilotuar dhe zbatuar zhvillimet në shërbime dhe aktivitete. Projekti i Universitetit për shëndetin, i cili kishte për qëllim promovimin e shëndetit dhe përfitimit të mirëqenies së komunitetit të Universitetit përmes angazhimit të stafit dhe studentëve në shëndetin dhe mirëqenien, hulumtim për mënyrën e jetesës së studentëve dhe të gjeturat e studentëve se çka mendojnë ata se si do të duket një Universitet i shëndetshëm, strategjitë / konsulencat për punësim, mbështetja e nxënësve në kontekstin e shkollës, zhvillimi i një rrjeti të komunikimit me studentët, mbështetja e kulturës së rritjes së vlerave, roli i mentorit personal, mënyra e kontaktimit të studentëve pas mbarimit të Universitetit, me qëllim të dihet shkalla e punësimit të tyre.



Në fund të vitit 2014, AKK mori pjesë në seminarin/takimin "Cilësia në edukimin e të rriturve dhe profesionalizimi i stafit", i cili u mbajt në Budvë/Mal të Zi.

Ky seminar ishte dy ditor dhe u organizua nga zyra DVV International e Serbisë dhe zyra e DVV International nga Prishtina por që u mbajt Budvë ne Mal te Zi me temën "Cilësia në edukimin e të rriturve dhe profesionalizimi i stafit". Çështjet e diskutuara në këtë forum ishin: Përvoja e Kosovës në sistemin e eduktimit;Përvoja Kosovës dhe Sllovenisë me njohjen e mësimit praprak dhe procesin e verifkimit te standardeve të profesionit, validimit dhe akreditmit, përvoja e Kosovës dhe Korniza Kombëtare e Kualifikimeve, roli i partnerëve social në zhvillimin dhe implementimin e Kornizës së Kualifikimeve, angazhimi dhe fuqizimi dhe i partnerëve social për pjesëmarrje ne zhvillimin e kualifikimeve, analizimi i tregut të punës për të evidentuar kërkesat dhe nevojat e tregut të punës; etj.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në Nëntor të vitit 2014 mori pjesë në Forumin vjetor të ECVET 2014, në Vienë me temën "Besimi në shkathtësi dhe kualifikimet në Evropën e së nesërmes". Në këtë forum morën pjesë përfaqësues nga shumë shtete të Evropës që kanë ndërlidhje me arsimin dhe aftësimin profesional, si Austria, Estonia, Kroacia, Sllovenia, Gjermania, Britania e Madhe, Finlanda, Turqia, Luksemburgu, Belgjika, etj.

Çështjet e diskutuara në këtë forum ishin: sfidat e ECVET në të kaluarën dhe ato që vazhdojnë ta përcjellin atë, nëse përdorimi i pikëve në formë të kredive apo vetëm rezultatet e të nxënit mjafton për transfer dhe mobilitet, ndërtimi i besimit në njohjen e shkthatësive dhe problemet që mund të dalin nga kjo anë, niveli i lartë i papunësisë në Evropë dhe mundësitë për krijimin e individëve të kualifikuar për t'u punësuar, kohezgjatja e shkollimit dhe mundësitë që krijon për punësim arsimi dhe aftësimi profesional.

Pastaj, implementimi i rezultateve të të nxënit përmes Kornizës së Kualifikimeve dhe ECVET, roli i partnerëve social në zhvillimin dhe implementimin e Kornizës së Kualifikimeve, angazhimi dhe fuqizimi dhe i partnerëve social për pjesëmarrje në zhvillimin e kualifikimeve, analizimi i tregut të punës për të evidentuar kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, krijimi i rrjetit online për t'u informuar dhe gjetur kualifikime dhe punë përmes rrjetit ECVET, procesi i zhvillimit të kualifikimeve dhe roli i standardeve të profesionit drejt zhvillimit të tyre, etj.



PAMJE NGA NJË NGA PUNËTORITË E MBAJTURA RRETH SIGURIMIT TË CILËSISË TË ORGANIZUARA NGA EQAVET



AKK-ja me ftesë të EQAVET mori pjesë në Konferencën Evropiane për sigurim të cilësisë Në nëntor 2014, drejtoresha e AKK-së bashkë me ekspertin e AKK-së morën pjesë në simpoziumin EQAVET për të mësuar nga qasjet sektoriale për sigurimin e cilësisë në AAP, i cili u mbajt në Bruksel. Pikat e diskutuara ishin: mesazhet kryesore dhe rezultatet e seminareve sektoriale EQAVET gjatë vitit 2011-2013, parashikimi i nevojave për aftësi, të mësuarit të bazuar në punës në një perspektivë të mësuarit gjatë gjithë jetës, aftësitë e mësimdhënësve dhe trajnerëve, etj.

Në dhjetor të vitit 2014, përfaqësues nga AKK me ftesë të Komisionit Evropian përmes Projektit TEMPUS LO@HEI, morën pjesë në vizitën studimore të mbajtur në Universitetin e Salzburgut në Austri që kishte për temë: Inkurajimi i procesit të zhvillimit të kurrikulave në bazë të rezultateve të të nxënit dhe hulumtimit të bazuar ne mësimdhënie në institucionet private të arsimit të lartë të Kosovës.Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga WUS Kosova, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe përfaqësues nga Institucionet e bartësve të Arsimit të Lartë privat nga Kosova.



SHËNIM: